



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 120-1/20 Data 23.05.2020
PRISHTINË

Në bazë të Nenit 68, pikës 6 të Statutit të Kolegjit "Biznesi" në Prishtinë me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor nr. 155/20 datë 29/05/2020, si dhe me Vendim të Bordit drejtues nr. 03/20 datë 20/05/2020 është miratuar:

RREGULLORE PËR PÛRKRAHJE FINANCIARE, BURSA DHE ZBRITJE PËR STUDENTËT NË KOLEGJIN "BIZNESI"

Neni 1 Baza Ligjore

1. Rregullorja bazohet në Ligjin nr. 04/L-037 "Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës", Statutin e Kolegjit neni 68, Rregulloren e brendshme të Kolegjit dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi.
2. Rregullorja respekton çdo akt ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Kosovës për çështjet e Arsimit të Lartë.

Neni 2 Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton llojet, kriteret, kushtet dhe përgjegjësitë e përfituesëve të përkrahjes financiare, bursave dhe zbritjeve në Programet studimore të Kolegjit BIZNESI.

Neni 3 Komisioni për administrim të përkrahjes financiare, bursave dhe zbritjeve për studentë

1. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor në mbledhjen e fundit të muajit Maj të vitit akademik krijon Komisionin për administrimin e përkrahjes financiare, bursave dhe zbritjeve të studentëve në nivel të Kolegjit Biznesi për vitin akademik vijues në përbërje e cila përfshin të gjitha palët e interesit:

- 1) Një mësimdhënës,
- 2) Një përfaqësues nga Administrata, dhe
- 3) Një studentë.

Neni 4

Procedura e aplikimit për përkrahje financiare, bursë dhe zbritje për studentë

1. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor shpall Konkurs për përkrahje financiare në javën e parë të muajit shtator të vitit akademik, konkursi zgjatën pesë ditë.
2. Studentët e interesuar për bursë përkatëse në fillim të muajit shtator duhet që pranë zyrës së studentëve të plotësojnë Kërkesë për bursë. Zyra për çështje studentore i përcjell formularët te Komisioni për administrim të përkrahjes financiare, bursa dhe zbritje për studentë. Studenti duhet të paraqesë:
 - 1) Kërkesë;
 - 2) Biografi, (CV);
 - 3) Vërtetim mbi shtetësinë e Republikës së Kosovës (nënshtetësinë, origjinale ose kopje e vërtetuar) jo më i vjetër se 6 muaj;
 - 4) Çertifikata e lindjes (origjinale ose kopje e vërtetuar) jo më e vjetër se 6 muaj.
 - 5) Dëshmitë e nevojshme të caktuara për llojin e bursës përkatëse për të cilën aplikon
3. Komisioni për administrim të përkrahjes financiare, bursa dhe zbritje për studentë shqyrton dhe vlerëson formularët e aplikimit brenda shtatë ditëve nga dita e plotësimit të formularëve nga ana e studentëve.
4. Për çdo vit akademik vijues, bursat rishqyrtohen nga Komisioni për administrim të përkrahjes financiare, bursa dhe zbritje për studentë dhe varësisht nga përmbushja e kritereve të përcaktuara studentit do t'i akordohet bursa e kategorisë gjegjëse.
5. Në rast që studentit përfiton bursë nga ndonjë institucion tjetër, nuk mund të përfitojë bursë nga Kolegji Biznesi.

Neni 5

Llojet e përkrahjes financiare, bursave dhe zbritjeve për studentë

1. Përkrahja financiare, bursat dhe zbritjet për studentët vlen vetëm për studentët e rregullt në ciklin e parë të studimeve – Studime Bachelor
2. Kolegji Biznesi në nivel të Programeve studimore për studentët ndanë këto lloje të përkrahjes:
 - a) Bursa të suksesit – gjatë regjistrimit në vitin e parë të studimeve;
 - b) Bursa meritore – bazuar në suksesin e treguar në vitin akademik paraprak;
 - c) Bursa sociale – për studentët me gjendje të rënduar sociale, dhe
 - d) Bursa për studentët me nevoja të veçanta.
3. Përkrahja financiare, bursa dhe zbritjet janë të vlefshme vetëm për studentët që plotësojnë kriteret e përcaktuara.
4. Bursat janë vetëm bursa studimi dhe nuk përfshijnë shpenzimet për akomodim dhe ushqim për studentët. Bursat e cituara janë për vit akademik (për dy semestra).
5. Studentët që plotësojnë kriteret për të përfituar më shumë llojeve të bursave, përfitojnë vetëm bursën me vlerë më të lartë.

Neni 6
Bursa të suksesit

1. Kolegji Biznesi për secilin Program studimor ndanë një bursë të suksesit me zbritje prej 100% nga shuma për studentin e radhitur në vendin e parë në listën përfundimtare.
2. Krite për radhitje të studentëve në listën përfundimtare janë rezultati i notave nga shkolla e mesme dhe pikët në provimin pranues në Programin studimor.
3. Për të përfituar bursë edhe në vitet e ardhshme akademike studenti duhet të kalojë të gjitha provimet e parapara me kurrikulë përfundimisht me afatin e shtatorit dhe të ruaj suksesin e tij në studime me notë mesatare mbi 9.0.

Neni 7
Bursa meritore

1. Kolegji Biznesi për secilin Program studimor ndanë një bursë meritore me zbritje prej 75% nga shuma për studentin me notë mesatare më të lartë në fund të vitit akademik duke i përfunduar të gjitha provimet e lëndëve të parapara me kurrikulën e Programit studimor në afatin e shtatorit.

Neni 8
Bursa sociale

1. Kolegji Biznesi për secilin Program studimor ndanë dy bursa sociale me zbritje prej 75% nga shuma për studentin që dëshmon gjendje të vështirësuar sociale gjatë aplikimit për regjistrim në vitin e parë ose gjatë studimeve në vitet akademike të ardhshme.
2. Studenti për bursë sociale në fillim të muajit shtator duhet të dorëzojë Kërkesë në administratën qendrore të Kolegjit Biznesi bashkërisht me Vërtetim prej Komunes për gjendjen e vështirësuar sociale të tij.
3. Komisioni për administrim të përkrahjes financiare, bursa dhe zbritje për studentë shqyrton dhe dorëzon propozimin deri te Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor për studentët të cilët plotësojnë kriteret për përfitim të Bursës sociale në kuadër të secilit program studimor.
4. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor në mbledhjen e fundit të muajit shtator miraton Listën e studentëve që kanë përfituar Bursën sociale në Programet studimore të Kolegjit Biznesi për vitin akademik.

Neni 9
Bursa për studentë me nevoja të veçanta

1. Kolegji Biznesi për secilin Program studimor ndanë dy bursa për studentë me nevoja të veçanta me zbritje prej 75% nga shuma për studentin që dëshmon gjendje për studime me nevoja të veçanta gjatë aplikimit për regjistrim në vitin e parë ose gjatë studimeve në vitet akademike të ardhshme.
2. Studenti për bursë për student me nevoja të veçanta në fillim të muajit shtator duhet të dorëzojë Kërkesë në administratën qendrore të Kolegjit Biznesi bashkërisht me dëshmitë për nevoja të veçanta të tij gjatë studimeve.
3. Komisioni për administrim të përkrahjes financiare, bursa dhe zbritje për studentë shqyrton dhe dorëzon propozimin deri te Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor për studentët të cilët plotësojnë

kriteret për përfitim të Bursës për studentë me nevoja të veçanta në kuadër të secilit program studimor.

4. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor në mbledhjen e fundit të muajit shtator miraton Listën e studentëve që kanë përfituar Bursën për studentë me nevoja të veçanta në Programet studimore të Kolegjit Biznesi për vitin akademik.

Neni 10

Shkaqet e ndërprerjes të përkrahjes financiare, bursës dhe zbritjes për studentin

1. Studenti që ndërpret studimet dhe largohet nga Kolegji Biznesi për arsye të ndryshme, nga data e largimit humbën të drejtën për të përfituar bursë të cilit do qoftë lloj.
2. Në rast të transferimit në Program studimor tjetër brenda Kolegjit Biznesi studenti humbën të drejtën e bursës.
3. Studenti që ka përfituar bursë është i detyruar të marrë pjesë në të paktën 80% të orëve të procesit mësimor gjatë semestrit.
4. Studenti që ka përfituar bursë nuk duhet të ngrijë studimet dhe nuk duhet të marrë asnjë masë disiplinore.

Neni 11

Procedura e ankimimit

1. Kandidati që është i pakënaqur me rezultatet e Listës preliminare të publikuar me përfituesit e llojeve të ndryshme të bursave për Programet studimore mund të paraqes Kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit brenda afatit prej 48 orësh nga shpallja e Listës preliminare të përfituesëve.
2. Komisioni për administrim të përkrahjes financiare, bursa dhe zbritje për studentë brenda afatit prej 72 orësh shqyrton ankesat e studentëve të pakënaqur dhe dorëzon Listën përfundimtare në Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor për miratim.
3. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor në javën e fundit të shtatorit miraton dhe publikon Listën përfundimtare me përfituesit e llojeve të ndryshme të bursave për Programet studimore në Kolegjin Biznesi.

Neni 12

Hyrja në fuqi

1. Rregullorja hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi Drejtues.

Neni 13

Zbatimi i Rregullores

1. Zbatimi i Rregullores monitorohet dhe sigurohet prej Dekanit të Kolegjit Biznesi.



Kryetari i KLMSH

Prof. Dr. Shyqeri KABASHI